



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.18/2011
Prishtinë, më 28.06.2011, ora 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Munguan : Teuta Sahatqija, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Natyra Kasumaj - KDI dhe Lejla Selimi - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.06.2011;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-26 për markat tregtare;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-28 për dizajnin industrial;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-29 për patenta;
6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për permbushjen e detyrimeve nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropiane, për vitin 2011;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.06.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 21.06.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-26 për markat tregtare;

Kryetari – tha për këtë pike të rendit të ditës e kemi edhe raportin preliminar të Projektligjit nr.04/L-26 për Markat Tregtare nga Njësia koordinuese e Komisionit ku vlerësohet së projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit. Shtoj me tej se për shkak të angazhimit të deputeteve edhe ne grupet tjera punuese nuk po ka rezultat të madh grupi punues i përbërë nga 3 apo 5 deputet, kështu që propozoj që të jetë vetëm një raportues për secilin projektligj ndërsa të gjithë deputetet tjerë mund të bashkëngjiten atë raportuesi dhe hapi debat në parim për këtë projektligj.

Hashim Deshishku – paraqiti vërejtje parimore tek Neni 15, 20 dhe 28, të cilat vërejtje tha se do të paraqet edhe në seance.

Sala Berisha – Shala- propozoj që raportues për këtë projektligj të jetë kryetari Zenun Pajaziti.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-26 për markat tregtare

Dhe Kuvendit i parashtron këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-28 për markat tregtare.

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Komisioni caktoj Zenun Pajazitin, raportues për të shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-26 për markat tregtare.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-28 për dizajnin industrial;

Kryetari – tha që për këtë pike të rendit të ditës e kemi edhe raportin preliminar të Projektligjit nr.04/L-28 për dizajnin industrial nga Njësia koordinuese e Komisionit, ku vlerësohet së projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit. Dhe hapi debat në parim për këtë projektligj.

Sala Berisha – Shala - propozoj që raportues për këtë projektligj të jetë Berat Buzhala në asistencë të deputetes Biserka Kostić.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-28 për dizajnin industrial.

Dhe Kuvendit i parashtron këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-28 për dizajnin industrial.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

Komisioni caktoj Berat Buzhalen raportues ne asistencë të Biserka Kostiç për të shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-28 për dizajnin industrial.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-29 për patenta

Kryetari – tha që edhe për këtë pike të rendit të ditës e kemi edhe raportin preliminar të Projektligjit 04/L-28 për dizajnin industrial nga Njësia koordinuese e Komisionit ku vlerësohet së projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit. Dhe hapi debat në parim për këtë projektligj.

Lutfi Zharku – propozoj deputetën Teuta Sahatqija për raportuese për këtë projektligj.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Projektligji nr.04/L-29 për patenta.

Dhe Kuvendit i parashtron këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-29 për patenta.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

Komisioni caktoj Teuta Sahatqine, raportuese për të shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-29 për patenta.

6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për permbushjen e detyrimeve nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropiane, për vitin 2011;

Kryetari – tha për këtë pike të rendit të ditës, ne si Komision pothuaj së të gjitha sfidat që dalin nga Raporti i progresit, që kanë të bëjnë me fushën që mbulojmë i kemi përmbushur në afatet e parapara. Në këtë rast falënderoj anëtarët e Komisionit për kontributin e tyre dhe stafin mbështetës të Komisionit për angazhim dhe ofrimin e asistencës së nevojshme.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i Komisionit për permbushjen e detyrimeve nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropiane, për vitin 2011.

7. Të ndryshme

a) Konferenca “Ndikimi i legjislacionit ne zhvillimin ekonomik dhe social te vendit”;

Kryetari - i njoftoj anëtarët e Komisionit lidhur me organizimin e konferencës që është propozuar nga ana Komisionit në mbështetje teknike të UNDP-së, me temën “Ndikimi i legjislacionit ne funksion te zhvillimit ekonomik dhe social te vendit”, qe do të mbahet ditën e mërkurë, 06 Korrik 2011, duke filluar nga ora 11:00, në Emerald Hotel.

b) Ftesa nga Parlamenti Evropian ne seminarin “ Transporti dhe infrastruktura ne kontekstin regjional – 12-13 korrik 2011;

Kryetari - i njoftoj anëtarët e Komisionit që sot e ka marre një ftesë nga Kryesia e Kuvendit, lidhur me një konferencë që do të organizohet në Bruksel në Parlamentin evropian, ku janë të ftuar 4 deputet nga Komisioni dhe 2 zyrtar të stafit mbështet të Komisionit, që do të mbahet me 12-13 korrik 2011.

c) Mbikëqyrja e zbatimit te ligjit për miniera dhe minerale;

Sala Berisha - Shala – kërkoj nga anëtarët e Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit te ligjit për miniera dhe minerale, që të jenë me aktiv dhe të marrin pjesë gjatë monitorimit të ligjit, po ashtu i ftoj të gjithë anëtarët e Komisionit që marrin pjesë në vizita punë që po zhvillon grupi punës. Njëkohësisht njoftoi Komisionin, së në agjendë të Grupit punues është të vizitohet Ferronikeli dhe KEK-u, si dhe komunën e Drenasit dhe atë të Obiliqit.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të ftohet z.Besim Beqaj ministër i zhvillimit ekonomik për të raportuar për nivelin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për miniera dhe minerale..

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit